



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

05/2024

# KODI I SJELLJES SË DEPUTETËVE

*Analizë e përputhshmërisë me parimet kushtetuese,  
Rregulloren e Kuvendit dhe me standardet e  
parlamenteve demokratike*

**7 QERSHOR 2024**



Autor: Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj, Betim Musliu, Gzim Shala dhe Astrit Kolaj.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund (RBF).

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Institut i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

7 Qershor, 2024  
Prishtinë, Republika e Kosovës



# Përmbajtja

---

09	Përmbledhje ekzekutive	18	Mos obligimi i deputetëve për të nënshkruar Kodin e Sjelljes
12	Hyrje	18	Mjeti Juridik
13	Shkeljet e etikës parlamentare në Kuvendin e Kosovës	19	Pamundësia e mendimeve mospajtuese dhe konkurruese të deputetëve
14	Natyra e Draft Kodit të Sjelljes	20	Vendosja e panevojshme e dispozitave të ligjit mbi deklarimin e pasurisë, dhuratave dhe konfliktit të interesit
15	Tejkalimi i autorizimeve	21	Përbërja problematike e Këshillit të Etikës
17	Cenimi i përfaqësimit të qytetarëve	22	Mos parashikimi i dispozitave për të hartuar dhe miratuar raportin vjetor të punës



## SHKURTESAT

<b>KRK</b>	Kuvendi i Republikës së Kosovës
<b>GP LV</b>	Grupi Parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!
<b>GP PDK</b>	Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës
<b>GP LDK</b>	Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës
<b>GP AAK</b>	Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
<b>GP LS</b>	Grupi Parlamentar i Listës Serbe
<b>GP MULTIETNIK</b>	Grupi Parlamentar i deputetëve nga komunitetet jo shumicë
<b>KiE</b>	Komisioni i Venecias
<b>RRPK</b>	Rregullorja e Punës së Kuvendit
<b>IKD</b>	Instituti i Kosovës për Drejtësi
<b>QRK</b>	Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>GJK</b>	Gjykata Kushtetuese
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës





## 1. Përmbledhje ekzekutive

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës miratimin e Kodit të Sjelljes për Deputetët. Ky Kod synon të vendosë parime, të përcaktojë sjelljet e papranueshme, të përshkruajë masat ndëshkuese dhe të formojë një Këshill të Etikës për zbatimin e këtij kodi. Edhe pse pati kohë të mjaftueshme prej një viti e nëntë muaj, për ta hartuar një kod në pajtim me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe standardet nderkombetare, Komisioni për Legjislacion nuk arriti të hartojë dhe të dërgojë në seancë plenare një draft të Kodit të Sjelljes në pajtim me këto dokumente.

Draft Kodi aktual përmban disa çështje të cilat minojnë efektivitetin dhe përafrimin e tij me Kushtetutën dhe standardet e parlamenteve demokratike. Për këto arsye Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) e ka parë të nevojshme publikimin e një dokumenti të tillë, në mënyrë që t'u ndihmojë deputetëve të kenë një qëndrim të mirinformuar sa i përket këtij draft kodi, për të cilin IKD kërkon nga Kryetari i Kuvendit dhe deputetët që një kod të tillë ta tërheqin nga miratimi prej seancës së ardhshme plenare, t'i bëjnë ndryshimet në përputhje me komentet e IKD-së dhe më pastaj ta sjellin për miratim.

Aspektet kryesore problematike të Draft Kodit të Sjelljes së Deputetëve janë:

1. Kodet e Sjelljes së deputetëve kanë për qëllim krijimin e kulturës politike duke pasur korrektësinë, transparencën dhe ndershmërinë. Draft Kodi i Sjelljes së Deputetëve nuk arrin të vendosë vullnetin dhe veprimet politike për arritjen dhe ngritjen e standardeve etike. Ai përqëndrohet në mënyrë ekskluzive tek rregullimi i sjelljes së deputetëve përmes sanksioneve përjashtuese dhe financiare të cilat përbëjnë dobësim të demokracisë përfaqësuese dhe se kufizimet që janë vendosur përmes këtij kodi reflektohen me cenim të përfaqësimit të qytetarëve përmes deputetëve që qytetarët kanë zgjedhur.

2. Përjashtimi i deputetëve nga tre (3) seancat e ardhshme plenare është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, sepse sipas saj deputeti mund të largohet nga seanca në të cilën ai kryen shkelje, por jo edhe në seancat e radhës, siç është në rastin konkret në Draft Kod, deri në tre (3) seanca. Sanksioni disiplinor i tillë, është tejkalim i aktit përmes të cilit Kuvendi merr të drejtën për të miratuar Kodin e Sjelljes së Deputetëve. Pasoja e përjashtimit duhet të vlejë vetëm në rastet kur veprimi jo parlamentar i deputetit ndodh

aty për aty dhe përjashtohet nga ajo seancë dhe jo nga seancat e ardhshme. Përtej kësaj, duhet theksuar se suspendimi/përjashtimi nga seancat e radhës të deputetit, mund të rezultojë në abuzim nga shumica parlamentare për t'i larguar deputetët e opozitës parlamentare dhe për të deformuar shumicën natyrore. Kështu, një dispozitë e tillë mund të sjellë deri tek përdorimi i tepruar i masës së përjashtimit në shumë seanca të cilat realisht do të ndikojnë në balancimin ndërmjet shumicës parlamentare dhe opozitës. Në anën tjetër, aplikimi i tillë i kësaj dispozite do të cenojë të drejtën e deputetit për t'i përfaqësuar qytetarët dhe të drejtën e tij kushtetuese për të marrë pjesë në procesin e votimit. Në rastin konkret, e drejta e deputetit si individ mbetet e nivelit të dytë, përballë të drejtës së qytetarëve që në Kuvend të përfaqësohen me deputetin/en që ata kanë votuar.

3. Dënimet financiare të parashikuara në këtë kod tejkalojnë sanksionet e përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit, e cila lejon sanksione deri në nivelin e shumës që është e barabartë me kompensimin për një seancë plenare, por jo deri në 50% të pagës bazë. Kjo është në kundërshtim me Rregulloren dhe lë Këshillin e Etikës me diskrecion të madh, që mund të çojë në arbitraritet. Dënimet financiare mund të mos jenë pengesë efektive për deputetët e pasur ose ata me të ardhura të konsiderueshme jashtë Kuvendit, dhe mund të shihet si çmimi i një veprimi politik. Përqendrimi në dënimet financiare zhvendos fokusin nga parimet e sjelljes së mirë dhe shërbimit publik në një sistem ndëshkimi thjesht monetar.

4. Kuvendi duhet të përfshijë në kod vlerat dhe standardet ndërkombëtare, të cilat duhet të reflektohen në punën e përditshme të deputetëve. Deputetët duhet t'i shohin parimet e Kodit të Sjelljes si aspekte pozitive dhe jo detyruese, gjë që drafti aktual nuk e arrin. Njëri nga qëllimet e kodit duhet të jetë inkurajimi dhe mirëkuptimi për mënyrën se si deputetët zbatojnë parimet dhe standardet që ata miratojnë, duke reflektuar mbi to dhe duke u sjellë sipas tyre.

5. Njohuria e deputetit mbi kodin konsiderohet që nga momenti i betimit si deputet, por ky rregullim është problematik sepse nuk përcakton se kush u'a dorëzon kodin deputetëve dhe lidhja që i bëhet betimit dhe njohurive mbi kodin është problematike sepse nuk mund të bëhet kjo çështje kështu. Drafti Kodi duhet të parashikojë saktësisht kush e dorëzon Kodin e Sjelljes dhe të kërkojë një deklaratë të nënshkruar nga deputeti që konfirmon pranimin dhe zbatimin e parimeve të kodit gjatë punës së tij.

6. Draft Kodi nuk parashikon mjetin juridik të ankesës ndaj vendimeve të Këshillit të Etikës, kjo në kundërshtim me Nenin 32 të Kushtetutës së Kosovës, që garanton të drejtën për mjet juridik. Mungesa e një dispozite ku parashihet mjeti juridik, është kundër konceptit themelor juridik për të drejtën e ankesës dhe standardeve parlamentare demokratike. Komisioni për Legjislacion duhet ta kthejë draftin e kodit dhe të sigurojë përfshirjen e të drejtës për ankesë dhe përcaktimin e organit kompetent për shqyrtimin e ankesave.

7. Draft Kodi i propozuar nuk u lejon deputetëve të kundërshtojnë vendimin e shumicës në Këshill të Etikës ose të japin mendime konkurruese kur pajtohen me votimin, por jo me arsyetimin e dhënë. Komisioni duhet të parashikojë mendimet mospajtuese dhe konkurruese për të ofruar argumente të qarta dhe të mbështetura mirë, duke sfiduar vendimet e shumicës dhe duke rritur thellësinë e analizës ligjore. Kjo do të kontribuojë në interpretimet dinamike të Kodit të Sjelljes.

8. Në kod janë përfshirë në mënyrë të panevojshme dispozita të Ligjit mbi deklarin e pasurisë, dhuratave dhe konfliktit të interesit. Kjo bartje dispozitash tregon për një nivel të ulët serioziteti nga hartuesi. Kodet duhet të përcaktojnë standarde të sjelljes dhe jo detaje të stërholluara, veçanërisht kur këto dispozita janë tashmë të përfshira në ligje ekzistuese.

9. Komisioni për Legjislacion ka vendosur dispozitën përmes së cilës përfaqësimi në Këshillin e Etikës të bëhet sipas rezultatit të zgjedhjeve parlamentare. Kjo përbërje presupozon që vendimet do të varen nga shumica parlamentare. Këshilli i Etikës nuk duhet të përdorë fuqinë politike për shkeljet e Kodit të Etikës, por të bazohet në dëshmitë e shkeljeve, duke vendosur me konsensus të plotë. IKD propozon që përbërja e KE-së të jetë e barabartë ndërmjet shumicës dhe opozitës, të përfshijë ish-gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, dhe kryesimi të bëhet nga opozita ose me rotacion.

10. Draft Kodi dështon të përfshijë dispozita për hartimin dhe miratimin e raportit vjetor të punës, gjë që cenon transparencën dhe llogaridhënien e Këshillit të Etikës. Kjo pamundëson planifikimin dhe prioritizimin e aktiviteteve të ardhshme dhe matjen e efektivitetit të punës së tyre.

Duke i adresuar këto rekomandime, Kuvendi i Kosovës mund të miratojë një Kod Sjelljeje më efektiv dhe pa të meta kushtetuese e ligjore dhe që rritë standardet etike pa cenuar përfaqësimin demokratik.

## 2. Hyrje

Më 28 korrik 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi Rregulloren e re të Punës, rregullore e cila u miratua pas dështimit për ta miratuar atë në legjislaturën e V-të, VI-të dhe VII-të. Kjo rregullore përfshiu edhe obligimin e Kuvendit që ta miratojë në një fazë të mëvonshme Kodin e Sjelljes së Deputetëve. Një kod i tillë ende nuk është miratuar, përkundër faktit se kanë kaluar me shumë se njëzet e dy (22) muaj nga hyrja në fuqi e Rregullores së Kuvendit. Përkundër faktit se Komisioni për Legjislacion kishte formuar Grupin Punues për hartimin e këtij kodi dhe ky grup kishte vizituar disa vende për të parë përvojat e tyre në këtë drejtim, për të vazhduar me hartimin e draftit të parë të këtij kodi, e të cilin e dorëzuan formalisht në komision për t'u shqyrtuar dhe proceduar për seancë plenare, pas vërejtjeve në Raportin për monitorimin e punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023[1], publikim i Institutit të Kosovës për Drejtësi.[2]

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e miratoi Kodin e Sjelljes së deputetëve më 30 prill 2024[3], duke përfshirë edhe disa ndryshime të cilat u bënë aty për aty nga disa deputetë, anëtarë të këtij komisioni.

Instituti i Kosovës për Drejtësi, ka analizuar këtë kod për të cilin ka dhënë vërejtjet e tij në ftesën e Komisionit për Legjislacion më 7 nëntor 2023. Pas ndryshimeve më 30 prill 2024, IKD i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe të gjithë deputetëve me komente në lidhje me draftin e propozuar dhe me ndryshimet e bëra në këtë datë.

Për shkak të metave të mëdha dhe pas ndryshimeve në mbledhjen e datës 30 prill 2024, IKD ka kërkuar nga Kryetari dhe deputetët, që Kodin ta tërheqin nga miratimi në seancën e datës 23 maj 2024, t'i bëjnë ndryshimet në përputhje me komentet e IKD-së dhe pastaj ta sjellin për miratim në seancë plenare.

---

[1] "Pas publikimit të raportit për punën e Kuvendit nga IKD, Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e sotme do ta trajtojë Draft-Kodin për sjelljen e deputetëve". Betimi për Drejtësi, Maj 2024. (Shih linkun: <https://betimiperdrejttesi.com/pas-publikimit-te-raportit-per-punen-e-kuvendit-nga-ikd-komisioni-per-legjislacion-ne-mbledhjen-e-sotme-do-ta-trajtoje-draft-kodin-per-sjelljen-e-deputeteve/>). (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

[2] Jakaj N. "Kuvendi i dështimeve-Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023." Prishtinë, Prill 2024. (Shih linkun: [2] [Neni 4, par. 3 dhe Neni 5, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Greva, 2012, Gazeta Zyrtare e Kosovës \(I qasshëm nga: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701\)](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701)). (Qasur për herë të fundit me 8 shkurt 2024). (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

[3] "Miratohet Kodi i Sjelljes për deputetët". Betimi për Drejtësi, 30 prill 2024. (Shih linkun: [2] [Neni 4, par. 3 dhe Neni 5, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Greva, 2012, Gazeta Zyrtare e Kosovës \(I qasshëm nga: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701\)](https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2701)). (Qasur për herë të fundit me 8 shkurt 2024). (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

Kodi nuk u miratua në seancë plenare me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit për shkak të mungesës të pjesëmarrjes së deputetëve nga partitë parlamentare opozitare.[4]

Ky dokument i shkurtër, ka për qëllim të trajtojë shqetësimet e ngritura përmes komenteve të IKD-së, në mënyrë që deputetët e Kuvendit e Kosovës para miratimit të tij në Kuvend, të kenë një qasje tjetër nga perspektiva e shoqërisë civile.

### 3. Shkeljet e etikës parlamentare në Kuvendin e Kosovës

Deputetët e Kuvendit janë të vetëdijshëm se marrja e detyrës në Kuvendin e Kosovës përfshin një sërë detyrimesh përveç privilegjeve. Qytetarët i shikojnë ata si shembull për t'i promovuar praktikat më të mira, për të zbatuar standardet dhe për t'i "penalizuar" sjelljet e pahijshme, duke pritur që deputetët t'i kryejnë këto përgjegjësi me zell. Praktikrat e mira, në secilën legjislaturë të Kuvendit të Kosovës nuk janë dëshmuar nga një pjesë e madhe e deputetëve të Kuvendit e po ashtu edhe nga Kryeministri dhe nga anëtarët e tjerë të qeverisë.

Puna në trupat e kuvendit, në komisione parlamentare dhe në seanca plenare është përcjellë nga përdorimi i gjuhës joparlamentare (gjuhës seksiste, raciste, mizogjene dhe gjuhës homofobe) dhe gati se gjatë secilës legjislaturë deputetët e Kuvendit janë përplasur fizikisht ndërmjet tyre dhe me kabinetin qeveritar e anasjelltas, në anën tjetër gjatë legjislaturës së VI-të, në Kuvend është përdorur edhe mjete të cilat sipas Kodit Penal përbëjnë vepër penale.

Sa i përket gjuhës jo parlamentare, të cilën Kodi i Sjelljes prezupozohet ta trajtojë, gjuha e tillë ka qenë e shpërfaqur veçanërisht në legjislaturën e VIII-të. Gjetjet e IKD-së, në dy raportet e monitorimit të punës së Kuvendit për vitin 2022 dhe 2023, tregojnë se në përgjithësi gjuha jo parlamentare veçanërisht ajo seksiste fillimisht ka nisur nga anëtarët e kabinetit qeveritar[5] e më pas edhe nga deputetët e tjerë të Kuvendit duke përdorur gjuhë raciste.[6]

---

[4] "Kuvendi zhvilloi punimet e seancës plenare". Kuvendi i Kosovës, 23 maj 2024. (Shih linkun: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/kuvendi-zhvilloi-punimet-e-seances-plenare-35279/>). (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

[5] "...Është i pakuptimtë epshi juaj për të marrë vëmendjen publike, por kjo është e parëndësishme.", fjala e përdorur nga zv. kryeministri Besnik Bislimi ndaj deputetes Ariana Musliu Shoshi. Jakaj N. "Kuvendi i dështimeve-Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023." Prishtinë, Prill 2024. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/04/WEB-Kuvendi-i-deshitimeve-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2023-.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

[6] "Valentina Bunjaku e LDK-së i thotë "magjup" e "majmun" deputetit Adnan Rrustemi". Koha, 22 qershor 2023. (Shih linkun: [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023\\_03\\_02\\_ts\\_Seanca\\_tK6hBcsfJt.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2023_03_02_ts_Seanca_tK6hBcsfJt.pdf), fq.7.). (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

Në anën tjetër, disa anëtarë të qeverisë së Kosovës nuk patën durimin që të lënë në foltoren e Kuvendit një fotografi të Kryeministrit të Kosovës, si një aksion simbolik të një deputeteje të opozitës parlamentare. Heqja e fotografisë, bëri që më pas deputetët dhe kabineti qeveritar të përdorë dhunën ndërmjet tyre, veprime për të cilat tashmë disa nga deputetët e përfshirë në përlëshje dhe Zëvendëskryeministri i Parë të përballen me aktakuzë të ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.[7]

Në anën tjetër, IKD në mjaft raste ka gjetur se Kryetari i Kuvendit dhe kryesuesit e seancave plenare, nuk kanë arritur që të respektojnë Rregulloren e Kuvendit sa i përket rasteve kur është krijuar rrëmujë. Në seancën e datës 13 korrik 2023, në vend se Kryetari të pezullojë seancën për shkak të rrëmujës, të pezullojë seancën dhe ta shtyhej për një ditë tjetër[8], ai thërret policinë e cila më shumë përkujdesej për sigurinë e Kryeministrit se sa të mbarëvajtjes së përgjithshme të seancës dhe pas një pauzë të shkurtër, Kryetari e rifilloi seancën plenare.

## 4. Natyra e Draft Kodit të Sjelljes

Kodi i sjelljes përbën dokumentin që formalisht do të rregullojë sjelljen e deputetëve duke përcaktuar çfarë konsiderohet sjellje e pranueshme dhe çfarë jo. Megjithatë, synimi që përgjithësisht kanë kodet e sjelljes është krijimi i kulturës politike duke pasur korrektësinë, transparencën dhe ndershmërinë.

Qëllimi i kodit nuk do të duhej të ishte rregullimi ekskluziv i sjelljes së përfaqësuesve përmes sanksioneve sepse kjo mund të përbëjë dobësim të demokracisë përfaqësuese. Secili kufizim jo i domosdoshëm reflektohet me cenim të përfaqësimit të qytetarëve përmes deputetëve që ata kanë zgjedhur.

Duke e pasur parasysh obligimin dhe nevojën për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duhet theksuar se zbatimi i këtij kodi është ekskluzivisht i varur nga niveli i vullnetit politik dhe jo nga masat sanksionuese të

---

[7] Shih për më shumë për gjuhën jo parlamentare në Kuvendin e Kosovës Raporti për Monitorimin e Punës së Kuvendit për vitin 2022 dhe 2023, kapitujt mbi gjuhën jo parlamentare të qasshme këto raporte nga këta linka: Dobët (2022): <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/DOBET-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2022.pdf> dhe Kuvendi i Dështimeve (2023): <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/04/WEB-Kuvendi-i-deshtimeve-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2023-.pdf>. (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

[8] "Neni 67, Rregullore e Kuvendit të Kosovës". Kuvendi i Kosovës, 28 korrik 2022. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61266>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

përcaktuara me këtë kod. Siç duket, Kuvendi i Kosovës është përballë me shumë probleme gjatë zhvillimit të seancave plenare, ku as roli i Kryetarit/Kryesuesit të seancës nuk ka mjaftuar që të zbatohen masat e tilla. Për këtë arsye, këto masa rrezikojnë të mbesin të pazbatuara, për shkak se në vetvete, norma nuk arrin të ketë sukses.

Kjo është arsyeja se pse mjeti kryesor për ngritjen e standardeve etike brenda Kuvendit duhet të jetë vullneti dhe veprimi politik dhe jo ekskluzivisht sanksioni financiar apo përjashtimi nga disa seanca të Kuvendit. Në mënyrën se si zhvillohet jeta institucionale brenda Kuvendit, norma të tilla jo proporcionale mund të jenë të paefektshme apo të kenë kundër efekt, por jo të arrijnë qëllimin që synohet. Në lidhje me dënimet e larta financiare (siç do të elaborohet, paraqesin tejkallim të kompetencave të Kuvendit), siç është përcaktuar me këtë kod deri në 50% të pagës bazë, dënimet mund të mos jenë një pengesë efektive për të gjithë deputetët, veçanërisht ata që janë të pasur në mënyrë të pavarur ose marrin të ardhura të konsiderueshme nga jashtë. E në raste të caktuara, ky sanksion mund të vlerësohet edhe si çmimi i një veprimi politik, i cili është në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi. Në anën tjetër, duke u përqendruar në dënimet financiare, do të humbet fokusi nga parimet e sjelljes së mirë dhe shërbimit publik në një sistem ndëshkimi thjesht monetar.

Kuvendi, duhet të synojë që përmes kodit të përfshijë vlerat dhe standardet e pranuar ndërkombëtare e më pas ato të reflektohen në punën e përditshme të punës së deputetëve. Deputetët duhet t'i shohin parimet e Kodit të Sjelljes si aspekte pozitive dhe jo detyruese, e këtë siç shihet drafti kodit nuk do arrin ta bëjë. Njëri ndër qëllimet e kodit, fillimisht duhet të jetë inkurajimi dhe mirëkuptimi rreth mënyrës së si deputetët i zbatojnë parimet dhe standardet që vet ata i miratojnë, pra reflektimi mbi parimet dhe sjellja e bazuar mbi to.[9]

## 5. Tejkallimi i autorizimeve

Baza për miratimin e Draftit Kodit të Sjelljes është Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Neni 129 i kësaj Rregullore përcakton se “Kodi i Sjelljes për Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës është akt i veçantë dhe miratohet nga Kuvendi me propozim të komisionit përkatës për Rregullore të Kuvendit”.

---

[9] “Review of the Code of Conduct: proposals for consultation”, fq. 12. House of Commons Committee on Standards, 29 nëntor 2021. (Shih linkun: <https://committees.parliament.uk/publications/7999/documents/82638/default/>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

Po në Rregulloren e Punës së Kuvendit janë të përcaktuara edhe llojet e masave që mund të ndërmerren ndaj deputetëve. Neni 64 i kësaj Rregullore liston gjithsej pesë (5) masa që mund të shqiptohen ndaj deputetëve, e që janë: 1.1. Tërheqja e fjalës; 1.2. Ndërprerja e fjalës; 1.3. Vërejtje; 1.4. Vërejtje me paralajmërim për largim nga seanca plenare; 1.5. Largim nga seanca plenare. Neni 66.3. i Rregullores në fjalë përcakton se “Masa “largim nga seanca plenare” shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me kompensimin për një seancë plenare”. Kështu, lista e masave që mund të shqiptohen ndaj deputetëve është shteruese.

Përkundër kësaj, Draft Kodi përmban dispozita që janë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit. Neni 26 i Draft Kodit përmban masat ndëshkuese për shkelje të dispozitave të deputetëve. Ndër të tjera, këto masa ndëshkuese janë: “...c. Suspendimi nga pjesëmarrja deri në tri (3) seanca plenare, varësisht nga niveli i shkeljes së Kodit. d. Suspendimi nga pjesëmarrja deri në tri (3) mbledhje të komisioneve, varësisht nga niveli i shkeljes së Kodit. e. Sanksionet financiare që përfshinë deri në 50% të pagës bazë”.

Kështu, sanksionet e përcaktuara në Draft Kod nuk janë në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kjo Rregullore ka lejuar sanksionin ndaj deputetit deri në nivelin e shumës që është e barabartë me kompensimin për një seancë plenare, por jo shumën prej 50% të pagës bazë. Në anën tjetër, Rregullorja e Punës së Kuvendit e ka përcaktuar mundësinë e largimit të deputetit nga seanca në të cilën deputeti kryen shkelje, por jo edhe në seancat e radhës, siç është në rastin konkret në Draft Kod, deri në tri (3) seanca.

Neni 76 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit”. Ndërsa, Kodi i Sjelljes së Deputetëve miratohet me shumicë të të gjithë deputetëve që janë prezent dhe që votojnë. Në këtë situatë, numri i votave të kërkuara flet edhe për rëndësinë e një akti të caktuar, në rastin konkret Rregullores së Punës së Kuvendit. Për këtë arsye, Kuvendi nuk ka mundësi që të tejkalojë Rregulloren e Punës, e cila miratohet me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit me një akt tjetër, në rastin konkret Kodin e Sjelljes për Deputetë, i cili miratohet me shumicë të thjeshtë të votave.

Për këtë arsye, dispozitat që kanë të bëjnë me sanksionet financiare paraqesin tejkalim të autorizimeve, për shkak se këto dispozita bien ndesh me Rregulloren e Punës së Kuvendit.



Lexuar në mënyrë të ndërlidhur nenin 129 të Rregullores së Punës së Kuvendit me nenet e tjera të kësaj Rregullore, Kuvendi ka për detyrë që të përcaktojë materien e shkeljeve, përkatësisht veprimet të cilat konsiderohet se paraqesin shkelje etike, por jo të përcaktojë norma të tjera, si në rastin konkret masat financiare, të cilat tejkalojnë dispozitat e një akti më të lartë siç është Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## **6. Cenimi i përfaqësimit të qytetarëve**

Sanksioni disiplinor, siç u shtjellua, për largimin e deputetit për tri (3) seancat e ardhshme për shkak të shkeljes së Kodit të Sjelljes është tejkalim i aktit përmes të cilit Kuvendi merr të drejtën për të miratuar Kodin e Sjelljes së Deputetëve. Pasoja e përjashtimit duhet të vlejë vetëm në rastet kur veprimi jo parlamentar i deputetit ndodh aty për aty, dhe përjashtohet nga ajo seancë dhe jo nga seancat e ardhshme.

Përtej kësaj, duhet theksuar se suspendimi/përjashtimi nga seancat e radhës të deputetit, mund të rezultojë në abuzim nga shumica parlamentare për t'i larguar deputetët e opozitës parlamentare dhe për të deformuar shumicën natyrore. Kështu, një dispozitë e tillë mund të sjellë deri tek përdorimi i tepruar i masës së përjashtimit në shumë seanca të cilat realisht do të ndikojnë në balancimin ndërmjet shumicës parlamentare dhe opozitës.

Në anën tjetër, aplikimi i tillë i kësaj dispozitë do të cenojë të drejtën e deputetit për t'i përfaqësuar qytetarët, për të drejtën e tij kushtetuese për të marrë pjesë në procesin e votimit. Në rastin konkret, e drejta e deputetit si individ mbetet e nivelit të dytë, përballë të drejtës së qytetarëve që në Kuvend të përfaqësohen me deputetin që ata kanë votuar.

Një gjë negative që mund të jetë edhe mungesa e mbajtjes së konsistencës. Kuvendi i Kosovës, në asnjë moment që nga themelimi i tij nuk ka pasur Këshill të Etikës. Kështu, ende nuk dihet se sa do të jetë në gjendje që ky këshill të sigurojë zbatim të vazhdueshëm të sanksionit të përjashtimit për shkak të historisë së shkurtër parlamentare në këtë çështje. Kjo është një arsye shtesë që në këtë fazë të hershme, mos të parashihen masa kaq ndërhyrëse.

## 7. Mos obligimi i deputetëve për të nënshkruar Kodin e Sjelljes

Në nenin 2, par. 3, i Kodit është paraparë që i njëjti t'i jepet deputetit/tes pas konfirmimit të zgjedhjes së tij/saj. Se ka njohuri deputeti mbi kodin, do të konsiderohet nga momenti i dhënies së betimit si deputet në seancën konstituive ose në një tërësi nga seancat kur një deputet bën betimin.

Rregullimi i tillë është problematik sepse fillimisht nuk dihet se kush i'a dorëzon deputetëve kodin e në anën tjetër, lidhja që i bëhet betimit dhe njohurive mbi kodin është problematike sepse nuk lidhet kjo çështje kështu. Draft Kodi duhet të parashohë në mënyrë saktë se kush e dorëzon Kodin e Sjelljes dhe bashkë me të një deklaratë të nënshkruar nga deputeti/ja se ai ka pranuar Kodin dhe se do t'i përmbahet atij gjatë punës së tij në komisione dhe në seancë plenare. Një rregullim të tillë e përmban Kodi i Sjelljes së anëtarëve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Anëtarët e këtij institucioni, me të marrë kredencialet, nënshkruajnë një deklaratë e cila përmban pohimin dhe deklarinimin e pajtimit me qëllimet dhe parimet bazë të Këshillit të Evropës, të cilat janë të përmendura në Preambulë dhe se deputeti merr përsipër që t'i përmbahet dispozitave të Kodit të Sjelljes.[10] Pranimi zyrtar i Kodit nga ana e deputetit mbështetet fuqimisht edhe në Indikatorët e Parlamentit Demokratik.[11]

## 8. Mjeti Juridik

Draft kodi nuk ka paraparë në asnjë prej dispozitave mjetin juridik të ankesës ndaj vendimit të Këshillit të Etikës. Në këtë mënyrë, ky draft është në kundërshtim me Nenin 32 (E drejta për mjet juridike) të Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, Draft Kodi i Sjelljes së Deputetëve del të jetë kundër konceptit themelor në sistemet juridike për të drejtën e ushtrimit të ankesës i cili siguron që një person ka të drejtë që rasti i tij të shqyrtohet nga një organ më i lartë se organi që ka marrë vendimin në shkallë të parë, në këtë rast nga Këshilli i Etikës.

Miratimi i Draft Kodit duke shmangur të drejtën e ushtrimit të ankesës, është kundër Kkushtetues, kundër ligjor dhe kundër standardeve parlamentare. Ushtrimi i të drejtës së ankesës kundër vendimeve të Këshillit të Etikës Parlamentare shërben si mekanizëm i

---

[10] "Kodi i mirësjelljes për anëtarët e Asamblesë Parlamentare". Asambleja Parlamentare e KiE, Janar 2022. (Shih linkun: <https://assembly.coe.int/LifeRay/APCE/pdf/Procedure/CodeOfConduct-EN.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

[11] "Treguesit për Parlamentet Demokratike". InterParliamentary Union (IPU), Tetor 2023. (Shih linkun:

<https://www.parliamentaryindicators.org/indicators/accountable/parliamentary-ethics/code-conduct>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

i kontrollit dhe balancit brenda një parlamenti. Këshilli i Etikës, duke qenë se është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e sjelljes dhe etikës së deputetëve, ai mund të marrë vendime që ndikojnë në reputacionin dhe veprimtarinë e deputetëve. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që deputetët të kenë një mjet për të sfiduar këto vendime.

Në disa vende, me rastin e miratimit të kodeve të sjelljeve dhe procedurave të marrjes së vendimeve në rast të shkeljeve janë paraparë edhe lloje të ndryshme të ankimeve. Në disa raste, është paraparë ankesë kundër gjetjeve të siç quhet Komisionerit dhe ankesa tjetër kundër vendimit të këshillave të etikës për sanksionet.[12]

Komisioni për Legjislacion... duhet që ta kthejë këtë draft në Komision dhe ta draftojë e të sigurohet që ka vendosur të drejtën e mjetit juridik dhe të përcaktojë organin kompetent që do t'i shqyrtojë ankesat e mundshme.

## **9. Pamundësia e mendimeve mospajtuese dhe konkurruese të deputetëve**

Në komisionet e veçanta parlamentare, të cilat themelohen me ligj[13] dhe procedurë të veçantë, parashihet që anëtarët e këtyre komisioneve në rastet kur votojnë kundër mendimit të shumicës, të mund të paraqesin mendim mospajtuës/kundërshtuës i cili formalisht nuk pajtohet me shumicën e komisionit. Në anën tjetër, me ligje dhe akte nënligjore[14] që rregullojnë punën e organeve të veçanta është paraparë edhe mundësia që anëtarët të kenë mundësinë e mendimeve konkurruese, për rastet kur deputeti pajtohet me vendimin por nuk pajtohet edhe me arsyetimin e dhënë.

Draft Kodi i propozuar nuk jep këtë mundësi. Në asnjë prej dispozitave të tij, nuk ka lënë hapësirë që deputetët të kenë mundësinë që të bëjnë një mendim mospajtuës/kundërshtuës apo mendim konkurrues.

---

[12] "Review of the Code of Conduct: proposals for consultation", fq. 53, 54 dhe 55. House of Commons Committee on Standards, 29 nëntor 2021. (Shih linkun: <https://committees.parliament.uk/publications/7999/documents/82638/default/>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

[13] "Neni 23, par. 3, Ligji Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar". Gazeta Zyrtare e Kosovës, 4 qershor 2010. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2683>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

[14] "Neni 56 dhe 57, Rregullore e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023". Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 7 korrik 2023. (Shih linkun: "Review of the Code of Conduct: proposals for consultation", fq. 53, 54 dhe 55. House of Commons Committee on Standards, 29 nëntor 2021. (Shih linkun: <https://committees.parliament.uk/publications/7999/documents/82638/default/>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

Në rastin e mendimeve mospajtuese, synimi duhet të jetë që deputetit/es t'i lihet mundësia e shprehjes së pikëpamjeve alternative në mënyrë që të ofrohet edhe argumente të qarta, të arsyetuara dhe të mbështetura mirë të cilat mund edhe të sfidojnë vendimin e shumicës.

Në rastin e mendimeve konkurruese, synimi duhet të jetë rritja e thellësisë së analizës ligjore, veçanërisht në arsyetimin e dhënë nga shumica e Këshillit të Etikës, duke kontribuar në natyrën dinamike të interpretimeve të Kodit të Sjelljes. Gjatë shkrimit të mendimeve konkurruese, deputeti/ja duhet të përdorë tekst që arsyeton pse janë injoruar ose refuzuar argumentet që ai/ajo përdor në mendimin konkurrues.

Mendimet mospajtuese dhe konkurruese bëhen pjesë përbërëse e vendimit të Këshillit të Etikës dhe publikohen së bashku dhe në të njëjtën kohë me vendimin e KE-së.

## **10. Vendosja e panevojshme e dispozitave të ligjit mbi deklarin e pasurisë, dhuratave dhe konfliktit të interesit**

Kodi përcakton një sërë çështje që vërehet se janë bartur nga ligje të tjera, në mesin e atyre dispozita të caktuara të Ligjit mbi Deklarimin e Pasurisë, Dhuratave dhe Konfliktit të interesit. Kodi në qëllimin e tij ka përcaktuar standardet etike të deputetëve të cilat duhet të respektohen gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Bartja e dispozitave të disa ligjeve, në vend se ato të jenë në formë të parimeve, tregon për lehtësinë dhe nivelin e ulët të seriozitetit me të cilin është marrë hartuesi i këtij kodi. Për më tepër, rregullat e sjelljes të përcaktuara në Nenin 7 (Konflikti i interesave), Nenin 8 (Mospërputhshmëria e funksionit të deputetit me aktivitetet tjera), Neni 9 (Deklarimi i pasurisë dhe dhuratave) dhe Neni 10 (Dhuratat) janë të përshkruara qartë dhe saktë në Nenin 3 (Parimet e përgjithshme të sjelljes së deputetëve).

Për të qenë më i zbatueshëm, ai duhet të jetë i pranueshëm nga të gjithë deputetët e Kuvendit. Pranueshmëria e tij bëhet reale edhe me faktin se kodet e tilla kur shkruhen dhe hynë në fuqi, më shumë përcaktojnë standarde të pranueshme të sjelljes se sa detaje të panevojshme e rregullta të stërholluara që të mbulojnë çdo eventualitet të mundshëm, për më tepër kur ato janë bartje e dispozitave të ligjeve në fuqi.

Deputetët e Kuvendit, me të marrë pozitën e deputetit/es, atij i dorëzohen dokumentet e nevojshme nga administrata e Kuvendit dhe stafi mbështetës politik i grupit të caktuar parlamentar, merr pjesë në sesione informuese mbi përgjegjësitë e tij në raport me ligje të caktuara dhe nuk ka se si të mos jetë i informuar mbi shkeljet që mund t'i bëjë gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Edhe për këtë arsye, konsiderohet se është e panevojshme vendosja e Nenit 7, 8, 9, dhe 10.

Nëse shihet për nga sasia e fjalëve, Draft Kodi i Sjelljes, më shumë i ka kushtuar rëndësi tekstit të panevojshëm të neneve të lartcekura se sa shpjegimit të parimeve që duhet t'i përmbahen deputetët. Numri i fjalëve tek nenet e bartura është 100% më i madh se sa te parimet. Praktika e vendeve të tjera, me demokraci të konsoliduar tregon se kodet e sjelljes së parlamentareve janë të shkurtër, të qartë dhe të saktë.[15] Në anën tjetër, procedurat për mënyrën se si zbatohet në rastet kur ka shkelje, janë të veçanta.[16]

## 11. Përbërja problematike e Këshillit të Etikës

Sa i përket përbërjes së Këshillit të Etikës, vërehet se Komisioni për Legjislacion ka marrë për bazë përbërjen e komisioneve parlamentare të përhershme dhe funksionale, e cila pasqyron përfaqësimin politik që ka dalë nga rezultati i certifikuar i zgjedhjeve parlamentare. Kjo në shikim të parë duket në rregull sepse përgjithësisht shumica duhet të jetë udhëheqëse për shkak të besimit më të madh që ka marrë nga qytetarët në raport me subjektin e dytë. Por, në raste të tilla, ligjvënësi, në këtë rast propozuesi Komisioni për Legjislacion... duhet të ketë parasysh se jo domosdoshmërisht përbërja e Këshillit të Etikës duhet të jetë e udhëhequr nga shumica parlamentare, sepse në këtë mënyrë kjo presupozon që Këshilli i Etikës, do të ketë parasysh në mënyrë absolute vetëm idenë që vendimmarrja do të varet nga shumica parlamentare. Shih rastet e themelimit të komisioneve hetimore parlamentare, ku njëri ndër instrumentet më të rëndësishme të kontrollit nga pakica parlamentare, puna e tyre në legjislaturën e VIII-të është përballë me probleme vetëm për shkak që shumicës parlamentare i është dhënë numri më i madh i

---

[15] "The Code of Conduct, together with The Guide to the Rules relating to the Conduct of Members". House of Commons, 12 dhjetor 2022. (Shih linkun: "[Review of the Code of Conduct: proposals for consultation](#)", fq. 53, 54 dhe 55. House of Commons Committee on Standards, 29 nëntor 2021. (Shih linkun: <https://committees.parliament.uk/publications/7999/documents/82638/default/>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

[16] "Procedural Protocol in respect of the Code of Conduct". House of Commons, 12 dhjetor 2022. (Shih linkun: <https://publications.parliament.uk/pa/cm5803/cmcode/1084/1084.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

anëtarëve e ku kjo shumicë (një më shumë në raport me opozitën) shihet se ka abuzuar me të drejtën ekskluzive të përfaqësimit në komisionet hetimore.[17]

Në mënyrë që të shmangen situatat e tilla, kur vendimet e Këshillit të Etikës të mos kontestohen për arsye politike ose arsye të tjera, ligjvënësi duhet të marrë parasysh që përbërja ndërmjet shumicës dhe opozitës parlamentare të jetë e barabartë dhe në përbërje të përfshijë edhe persona të jashtëm me integritet të lartë profesional dhe etik. Do të ishte e udhës që ligjvënësi të parasheh që pjesë e Këshillit të Etikës të jenë ndonjëri nga ish-gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese ose të ndonjë institucioni tjetër që mandati i tij ka përfunduar tre ose pesë vite prej që emërohet anëtar i Këshillit të Etikës. Në anën tjetër, Komisioni për Legjislacion duhet të ketë parasysh që kryesimi i Këshillit të bëhet nga deputetët nga radhët e opozitës parlamentare.[18] Në këtë drejtim, një opsion tjetër mund të jetë udhëheqja me rotacion, një rregull të tillë e gjejmë te Komiteti Këshillëdhënës për Sjelljen e Anëtarëve të Parlamentit Evropian.[19]

Draft kodi në Nenin 22, par. 2 ka lënë mundësinë që në rastet kur një grup parlamentar nuk dëshiron të propozojë anëtar në Këshill – edhe pse kjo e drejtë i është dhënë, kjo e drejtë i bartet grupit tjetër përkatës parlamentar në radhë. Me të drejtë është formuluar një dispozitë e tillë, por këtu hasim një problem teknik. Kësaj dispozitë duhet shtuar një shtesë tjetër ose të riformulohet në kuptimin që duhet caktuar një afat i arsyeshëm që grupi parlamentar propozues e bën pranë Kryesisë së Kuvendit. Një gjë të tillë, Draft Kodi ka dështuar ta bëjë.

## **12. Mos parashikimi i dispozitave për të hartuar dhe miratuar raportin vjetor të punës**

Hartimi dhe miratimi i një raporti vjetor të punës janë komponentë thelbësorë të trupave të Kuvendit të Kosovës. Edhe pse Draft Kodi ka përfshirë çështje procedurale, për të cilin

---

[17] Jakaj N. "Kuvendi i dështimeve-Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023", fq. 55. Prishtinë, Prill 2024. (Shih linku: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/04/WEB-Kuvendi-i-deshtimeve-Raport-i-monitorimit-te-punes-se-Kuvendit-te-Kosoves-per-vitin-2023-.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 7 maj 2024).

[18] "Review of the Code of Conduct: proposals for consultation", fq. 81. House of Commons Committee on Standards, 29 nëntor 2021. (Shih linkun: "[Procedural Protocol in respect of the Code of Conduct](https://publications.parliament.uk/pa/cm5803/cmcode/1084/1084.pdf)". House of Commons, 12 dhjetor 2022. (Shih linkun: <https://publications.parliament.uk/pa/cm5803/cmcode/1084/1084.pdf>). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

[19] "Rregulla 4, e Rregullores së Punës së Komisionit Këshillëdhënës për sjelljen e anëtarëve të Parlamentit Evropian". Parlamenti Evropian, 14 nëntor 2023. (Shih linkun: [https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/Rules\\_of\\_Procedure\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/Rules_of_Procedure_EN.pdf)). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).

cilin aspekt më lartë kemi thënë se ato duhet të jenë të ndara prej parimeve të kodit dhe meqenëse tashmë kemi një kod ku janë të përfshirë parimet dhe procedurat, Draft Kodi dështon ta vendosë një çështje esenciale siç është vendosja e një dispozite ku parashihet hartimi dhe miratimi i raportit vjetor të punës për vitin paraprak.

Mosvendosja e një dispozite të tillë, cenon rëndë transparencën dhe llogaridhënien, nuk e mban përgjegjës ndaj publikut dhe palëve të tjera të interesuara Këshillin e Etikës. Nuk mund të planifikohet dhe të prioritzohen aktivitetet e ardhshme për shkak që nuk janë të përmbledhura ato të kaluarat dhe nuk mund të masë efektivitetin e punës së vet Këshillit të Etikës.

Një kod i sjelljes, që i mungon hartimi dhe miratimi i një raporti vjetor të punës është përgjithësisht i padëshirueshëm dhe që nuk duhet marrë besimin e deputetëve. Raportet e tilla, janë vendimtare për të garantuar transparencë, llogaridhënie, planifikim strategjik dhe komunikim efektiv. Prandaj, përfshirja e kërkesës për hartimin dhe miratimin e Raportit vjetor të punës në Kodin e Sjelljes është një praktikë më e mirë që mbështet qeverisjen e mirë dhe funksionimin e fuqishëm legjislativ.[20]

Mbi arsyet e lartcekura, Komisioni për Legjislacion duhet të vendosë dispozita të qarta ku parasheh miratimin e Raportit vjetor të punës, të specifikojë datën dhe muajin kur ky raport ju shkon deputetëve për njoftim dhe për miratim, dhe kohën kur publikohet për miratim në faqen zyrtare të Kuvendit.

---

[20] "Rregulla 14, e Rregullores së Punës së Komisionit Këshilldhënës për sjelljen e anëtarëve të Parlamentit Evropian". Parlamenti Evropian, 14 nëntor 2023. (Shih linkun: [https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/Rules\\_of\\_Procedure\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/Rules_of_Procedure_EN.pdf)). (Qasur për herë të fundit me 8 maj 2024).







